



Center for Legal  
Support and Advocacy

Qendra për Mbështetje Ligjore dhe Advokaci

# Manual

për

## Informacion dhe Akses në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë

**Me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të  
Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA Tiranë.**



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania

## **Përmbajtja**

- I. Informacion mbi organin e Prokurorisë në RSH...fq. 3
- II. Nëse jeni qytetar dhe doni të merrni vërtetime, informacion, të keni akses.....fq. 10
- III. Nëse jeni palë në procesin hetimor .....fq. 13
- IV. Nëse jeni avokat i një çështjeje nën hetim .....fq. 21
- V. Aktet që duhet t'i drejtoheni Prokurorisë .....fq. 31
  - a. Kërkesë për Informacion
  - b. Formular Ankese
  - c. Memo
- VI. Aktet që ju garantojnë aksesin në Prokurori ....fq. 43
  - a. Rregullore mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve
  - b. Rregullore e brendshme e Prokurorisë
  - c. Ligji për funksionimin dhe organizimin e organit të Prokurorisë

## **I. INFORMACION MBI ORGANIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Prokuroria është organi që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq, parashikim të cilin e gjejmë në nenin 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Funkcionin e saj e ushtron në bazë të tërësisë së legjislacionit në sistemin e Republikë së Shqipërisë, por konkretisht në bazë të Kushtetutës dhe Kodit të Procedurës Penale si dhe të Kodit Penal.

Angazhohet që në veprimet e veta të zbatojë me përpikmëri dhe rigorozitet të drejtat e njeriut, detyrimet e saj si organ hetimor dhe palë në gjyq dhe të mbrojë akuzën publike ashtu siç ligji e parashikon.

Detyrën e saj prokuroria e ushtron pranë sistemit gjyqësor, çka do të thotë që është një institucion që nuk jep drejtësi, por vjen në ndihmë të institucioneve të drejtësisë dhe në shërbim të hetimit të veprave penale dhe akuzave të ngritura. Përfaqëson akuzën në gjyq, që do të thotë mbron interesat e shtetasve të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet hetimeve të kryera, luftës kundër kriminalitetit dhe kontributit që jep në zbulimin e veprave penale deri në akuzimin e subjekteve që kanë shkelur ligjin në aspektin penal.

Hetimet janë në tagër të prokurorisë dhe në diskrecion të plotë të saj, pasi është prokurori që i orienton dhe i drejton ato me ndihmën e policisë gjyqësore.

## ***Neni 24 i Kodit të Procedurës Penale***

### ***Funksionet e Prokurorisë***

***1. Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.***

***2. Prokurori ka të drejtë të mos fillojë procedimin, të pushojë akuzën ose çështjen, t'i kërkojë gjykatës pushimin e akuzës ose të çështjes, si dhe të kërkojë dërgimin e çështjes në gjyq, sipas rasteve të parashikuara nga ky Kod.***

***3. Prokurori ka të drejtë të lidhë marrëveshje bashkëpunimi, të hartuara në zbatim të nenit 37/a, të këtij Kodi, dhe të dispozitave ligjore të veçanta për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.***

***4. Prokurori mund të arrijë një marrëveshje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, në përputhje me nenin 406/d e vijues të këtij Kodi.***

5. *Prokurori mund të paraqesë në gjykatë kërkesë për miratimin e urdhrit penal sipas parashikimeve të këtij Kodi.*

6. *Kur nuk është i nevojshëm ankimi i viktimës, ndjekja penale ushtrohet kryesisht.*

Të gjithë punën e saj e kryen me transparencë të plotë, për aq sa nuk dëmtohen hetimet, çka do të thotë që palët në proces kanë informacion për veprimtarinë e prokurorisë sipas rastit. Kushdo ka të drejtë të informohet për veprimet që ndërmerren në emër të tij dhe për çdo hetim në ngarkim të tij, detyrim që buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

*Neni 28*

1. *Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij.*

Ky është një detyrim themelor, por që na bën të kuptojmë se angazhimi i ligjit për të drejtën e informimit është maksimal edhe për subjektet që dyshohet të kenë shkelur ligjin. Në frymë të Kushtetutës është ndërtuar edhe Kodi i Procedurës Penale në tërësi të tij, për të mos lënë palët për informacion dhe për të mos iu shmangur asaj që konsiderohet një ndër liritë themelore, të drejtës

për informacion. Konkretisht, nga neni 34 deri te neni 47 i Kodit të Procedurës Penale, janë të drejtat e të pandehurit, të parashikuara në mënyrë specifike, e drejta për të marrë dijeni dhe për t'u informuar në kohë. Ligji ka avancuar akoma më shumë dhe i ka zgjeruar të drejtat e viktimës nga vepra penale. Të drejta këto, risi për praktikën tonë dhe nuk njiheshin deri më sot, janë integruar me ndryshimet e fundit duke sjellë një modernizim të legjisllacionit.

Pikërisht, problematika aktuale qëndron në këtë pikë, për faktin se ligjzbatuesit nuk janë kultivuar me këtë edukate ligjore dhe nuk e kanë konceptuar institutin e mbrojtësit të viktimës me tagra të plota. Si dhe ka qenë mjaft e vështirë të ambientohen me idenë e informacionit të detajuar edhe për viktimën, fakt ky që e ka gjetur organin e prokurorisë të papërgatitur për sa i përket stafit dhe angazhimit në përgjigje të informacionit për viktimën.

Konkretisht për çdo qytetar të hetuar për vepra penale, mbrojtësi i tij tashmë ka të drejta të zgjeruara dhe mjaftueshëm mundësi për të qenë i përfshirë në procesin hetimor. Ligji procedural penal i mbron ata në mënyrë të posaçme në nenin 58.

## **Neni 58**

### **Të drejtat e viktimës së veprës penale**

*(Shtuar pika 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

*1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:*

*a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;*

*b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;*

*c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;*

***ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;***

***d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;***

***dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;***

***e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirim të tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;***

***ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;***

***f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;***

***g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;***

gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;

h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;

i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;

j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

2. Organi procedues **njofton menjëherë viktimën** për të drejtat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.

3. Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

4. Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1 të këtij neni. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

Pra, siç shihet nga dispozita ligjore, ka të drejta të informohet, të njoftohet, të jetë i pranishëm në fazat kyçe



të procedimit. Të depozitohet prova e të marrë prova. Gama e të drejtave dhe kryesisht mundësisë për informacion është zgjeruar mjaftueshëm, por e gjithë situata qëndron në faktin se si do të vihet në zbatim tashmë kjo mundësi që i është viktimës. Pikërisht i gjithë studimi është orientuar në këtë drejtim, në mundësinë që duhet të kenë palët në proces të bëjnë kërkimin e të drejtave të tyre, pasi ligji në të vërtetë i parashikon të gjitha, por duhet të dimë t'i gjejmë këto dispozita dhe duhet të dimë t'i aplikojmë këto të drejta. Ky manual mundëson këdo të kërkojë të drejtat e tij, të marrë informacion dhe të angazhohet në procesin hetimor.

Kryesisht kur viktimat ose i pandehuri ka mbrojtës, aksesin në organin e Prokurorisë bëhet më i thjeshtë, por jo se ka mjete për ta realizuar këtë, por vetëm në sajë të të faktit se janë aktorë të njohur në proces dhe mund të veprojnë më lirshëm në Prokurori.

Ndryshe qëndron situata nëse cdo qytetar i drejtohet Prokurorisë, për të marrë vërtetim për gjendjen gjyqësore, për të marrë vërtetim nëse ka një proces hetimor që prek interesat e tij në një proces tjetër, etj., dukë qenë se nuk kanë arsye të marrin edhe mbrojtës, aksesin në Prokurori bëhet më i vështirë.

Sërish theksojmë se edhe në këtë rast, ligji i parashikon të drejtat, por qytetarët me një formim jo-juridik nuk e kanë edhe aq të lehtë të realizojnë qëllimin e tyre në lidhje me vërtetimet që kërkojnë.

## II. NËSE JENI QYTETAR DHE DONI TË KRYENI KËTO VEPRIME

### a) Të merrni një vërtetim

Vërtetimi mund të jetë për efekt provueshmërie se nuk keni asnjë hetim penal në ngarkim *Tuajin* (zakonisht vërtetim që kërkohet në një konkurs, në ambasada, në aplikimin e një vendi pune, etj). Ky vërtetim është një ndër veprimet më të thjeshta në organin e Prokurorisë, e drejtë e qytetarit për të marrë informacion në lidhje me të dhënat e tij si edhe detyrim i çdo institucioni që t'ia japë këtë informacion secilit shtetas të tij.

Kjo e drejtë – detyrim mbrohet me ligj dhe parashikohen të gjitha mjetet juridike për ta kërkuar këtë:

- ***Neni 15 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,***  
“... Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre...”
- ***Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,***
  1. E drejta e informimit është e garantuar.
  2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.

3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

- **Neni 12 E drejta për akses parashikuar në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”**

1. Çdo person ka të drejtë që pa pagesë, me kërkesë me shkrim, të marrë nga kontrolluesi:

a) konfirmimin nëse të dhënat personale po i përpunohen ose jo, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale;

b) në një formë të kuptueshme, të dhënat personale dhe informacionin e disponueshëm për burimin e tyre;

c) në rastet e vendimeve automatike, sipas nenit 14 të këtij ligji, informacion për logjikën e përfshirë në vendimmarrje. Informacioni për të dhënat komunikohet në formën, në të cilën ishin në kohën kur është bërë kërkesa.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

3. E drejta për akses, sipas pikës 1 të këtij neni, ushtrohet në përputhje me parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe informacionit, lirisë së

shtypit dhe sekretit profesional dhe mund të kufizohet, nëse cenon interesat e sigurisë kombëtare, politikën e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale.

4. E drejta e aksesit nuk mund të ushtrohet në rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 10 të këtij ligji.

5. Në rast se aksesit mohohet, duke argumentuar se cenohen interesat e sigurisë kombëtare, politika e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimi dhe ndjekja e veprave penale ose liria e shprehjes dhe informimit apo liria e shtypit, subjekti i të dhënave mund t'i kërkojë komisionerit të kontrollojë përjashtimin në rastin konkret. Komisioneri informon subjektin e të dhënave për masat e marra.

- **Neni 3 i ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”**

E drejta e informimit

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.

3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit

original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Për të realizuar këtë veprim çdo qytetar duhet të bëjë një kërkesë të thjeshtë, duke shpjeguar arsyen për të cilën e do këtë informacion, së bashku me të dhënat e sakta të tij duke i bashkëlidhur një dokument identifikimi. Depozitimi bëhet në sportelet e Prokurorisë çdo të martë dhe të enjte nga ora 14.00 – 16.00.

Përgjigjja vjen me postë në adresën që keni lënë në dispozicion ose mund të paraqitet sërish qytetari për ta marrë në po të njëjtët sportele.

### **III. NËSE JENI PALË NË PROCESIN HETIMOR**

Përveç të drejtave për informacion, të drejtës për akses, të cilat mbrohen në mënyrë të posaçme për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë, subjekt në procesin penal mund të jetë në cilësinë e viktimës, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, të të pandehurit, etj.

Në këtë rast mjete juridik është:

- Memo;
- kërkesë për informacion;
- kërkesë për vërtetim;
- kërkesë për kopje aktesh;
- po ashtu edhe takim të drejtëpërdrejtë në Prokurori.

**a) Sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale,**

***Neni 110***

*Memoriet dhe kërkesat e palëve*

*1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim.*

*2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve. Palët në proces gjyqësor mund të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim.*

Kjo memo konsiston për rastet kur palët duan të dinë se në ç'fazë është hetimi, se çfarë veprimesh hetimore janë kryer nga organi hetimor, etj.

**b) Sipas nenit 105 të Kodit të Procedurës Penale,** palët kanë të drejtë të bëjnë kërkesa për marrjen e kopjeve të akteve dhe të ekstrakteve:

***Neni 105***

*Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve*

*(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

- 1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive.*
- 2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor.*
- 3. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit*

**c) Sipas ndryshimeve të fundit të Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, janë rritur të drejtat e viktimës në procesin penal duke i dhënë më shumë akses e mundësi informacioni në procesin penal.**

Viktima sipas nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, ka të drejtë të ketë mbrojtës, ka të drejtë të depozitojë prova, ka të drejtë të njihet me prova, të kërkojë informacion për fazën e hetimeve; po ashtu viktimës duhet t'i vihen në dispozicion të gjithë provat e mbledhura gjatë hetimeve. Këtë mund ta bëjë me avokat ose pa avokat sipas rastit, por në rast se nuk ka mundësi për të marrë avokat, shteti mundet t'i sigurojë atij mbrojtje ligjore falas.

#### **d) INFORMACION PËR SHORTIN**

Një ndër pikat që kemi studiuar gjatë projektit, ka qenë në lidhje me informacionin për shortin, që ka të bëjë me të drejtën e palëve për të ditur se me kë po hetohen.

Vështirësia në këtë rast qëndron në faktin se nuk e gjejmë të shkruar shprehimisht në ligj detyrimin e organit të akuzës për të na dhënë një informacion të tillë, prandaj edhe aksesimi për këtë informacion bëhet edhe më i pamundur. Nga ana tjetër, mendojmë se është detyrim dhënia e informacionit se me cilin prokuror po hetohet çështja, që në momentet e para, për të gjitha palët në proces hetimor. Pasi detyrimi për një hetim të drejtë është paanshmëria dhe transaparenca e hetimeve, për të zbuluar të vërtetën dhe të drejtën. Në Kodin e Procedurës Penale për të rregulluar barazinë e palëve, hetimin e drejtë, për të ruajtur paanshëmrinë e prokurorit në orientimin e hetimeve parashikohen institute që kontrollojnë këto parime, konkretisht zëvendësimi i prokurorit.

## ***Neni 27***

### ***Rastet e zëvendësimit të prokurorit***

*(Ndryshuar paragrafi 1 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar fjalë në pikën 1 dhe shfuqizuar pika 2, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

*1. Drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin e prokurorit, kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 paragrafi i parë shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”. Në rastet e tjera prokurori zëvendësohet vetëm me pëlqimin e tij.*

*2. Shfuqizuar.*



3. Rregullat e caktuara për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit zbatohen edhe për oficerin e policisë gjyqësore.

#### **Neni 16**

#### **Papajtueshmëria për arsye lidhjeje familjare, gjinie ose krushqie**

**(Shtuar fjalë me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)**

1. Në të njëjtin procedim nuk mund të marrin pjesë si gjyqtarë personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim, bashkëshortë, bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave) ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjehërrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka).

#### **Neni 17 Heqja dorë**

**(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)**

1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete:

a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij;

b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij; c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit;

ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njëerën prej palëve private;

d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale;

dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim;

e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16;

ë ) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse, i cili e miraton ose e refuzon atë me vendim të arsyetuar.

3. Mbi deklarin e heqjes dorë të kryetarëve të gjykatave vendosin kryetarët e gjykatave të një shkalle më lart. Mbi deklarin e heqjes dorë të kryetarit të Gjykatës së Lartë vendos një trup gjykues i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga tre gjyqtarë.

Në interpretim të këtyre dispozitave, dalim në konkluzionin se ligji parashikon mundësinë, që palët në proces të kërkojnë zëvendësimin e prokurorit për rastet e papajtueshmërisë së tij apo për çdo rast që cenon hetimet e drejta. Por këtë palët duhet ta bëjnë në kohë reale, pa kryer veprime hetimore prokurori, pasi ky është ratio leges i ligjvënësit që të shmangë anshmërinë dhe pabarazinë. Çdo subjekt duhet të njihet me emrin e

prokurorit që e heton atë, pasi mund të jetë një ndër shkaqet ligjore për të cilat duhet të zevëndësohet prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore. Pikërisht për këtë arsye, duhet t'i jepet e drejta çdo qytetari si palë në një proces hetimor, si në cilësinë e viktimës ashtu edhe në atë të pandehurit, apo palës private në proces hetimor, që të dijë se kush është subjekti që po drejton hetimet dhe po i orienton ato.

Prandaj organi i akuzës duhet të lejojë depërtimin e informacionit në lidhje me shortin e çështjes, pasi kështu palët mund të heqin çdo dyshim për anshmëri dhe për pabarazi, apo çdo qëndrim tjetër që mund të cenojë procesin hetimor.

#### **e) KUFIZIMI I INFORMACIONIT ME LIGJ**

E drejta për informacion është një e drejtë jonatyrore dhe për rrjedhojë ka kufizime përkatëse në sajë të mbrojtjes të të drejtave të tjera. Sjellim në vëmendje faktin, se në bazë të teorisë së balancimit të të drejtave si dhe parimit të proporcionalitetit<sup>1</sup>, ligjzbatuesit duhet të vendosin kur një e drejtë duhet të kufizohet në atë masë që të prevalojë e drejta tjetër për një interes më të lartë. Kështu ndodh edhe me detyrimin e ruajtjes së sekretit hetimor, i cili kufizon të drejtën për informacion, në interes të hetimeve duke e mbështetur atë në ligj. Pra, shohim se në nenin 279 të Kodit të Procedurës Penale, e drejta për

---

<sup>1</sup> Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

të marrë informacion kufizohet jo pafundësisht, por për një kohë aq sa provohet se duhet për të mbrojtur interesat e hetimeve, në emër të zbulimit të veprës penale.

Në këto raste, çdo qytetar përballet me këtë barrierë dhe normalisht të drejtë, por nga ana tjetër është organi i akuzës që duhet të justifikojë, së pari se pse përbën sekret dhe, së dyti në përfundim të hetimeve ka detyrimin të bëjë publik këtë sekret dhe ta arsyetojë me vendim. Ligjvënësi ka vendosur në këtë formë, pasi shkak i mbajtjes sekret (dëmtimi i hetimeve) tashmë bie, duke qenë se jemi para ngritjes së një akuze dhe veprimtaria hetimore e prokurorisë përfundon aty dhe kalon në një stad tjetër, në gjykimin e akuzës në Gjykatë.

## **Neni 279**

### **Detyrimi për të ruajtur sekretin**

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Aktet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në rast nevoje për vazhdimin e hetimeve prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve.
2. Prokurori mund të lejojë, me vendim të arsyetuar, publikimin e akteve të veçanta ose të pjesëve të tyre. Aktet e publikuara depozitohen në sekretarinë e prokurorit.
3. Edhe kur aktet nuk mbrohen më nga sekretin, sipas paragrafit 1, të këtij neni, në rastet kur është e nevojshme

për vazhdimësinë e hetimeve, prokurori mund të disponojë me vendim të arsyetuar:

a) detyrimin e ruajtjes së sekretit për akte të veçanta, kur i pandehuri jep pëlqimin ose kur njohja e përmbajtjes së aktit mund të pengojë hetimet ndaj personave të tjerë;

b) ndalimin e publikimit të përmbajtjes së akteve të veçanta apo të dhënave të posaçme që lidhen me veprime hetimore të caktuara.

#### **IV. NËSE JENI AVOKATI I NJË ÇËSHJTEJE NËN HETIM**

Siç e përmendëm edhe më lart, palët në procesin hetimor kanë marrë tagra më të zgjeruara duke rritur pjesëmarrjen e tyre në procesin hetimor. Ky fakt parashikohet në ligj dhe mbrohet sipas mjeteve juridike ku mungesa e kësaj pjesëmarrje passjell pavlefshmëri të akteve të marra në hetim dhe gjatë gjykimit. Në kushtet kur të dy palët në procesin hetimor, si viktima ashtu edhe i pandehuri kanë të drejtën të marrin mbrojtësin e tyre përkatësisht, kështu kanë konfirmuar barazinë e palëve edhe në fazën e hetimeve. Për një aplikim më të mirë të ligjit dhe për mundësi mbrojtjeje efektive, ashtu sic e kërkon KEDNJ, konkretisht në nenin 6 të saj garantohet e drejta për një proces të rregullt:

***E drejta për një proces të rregullt***

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i

*mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*

*d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;*

*e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.*

Në interpretimin literal dhe logjik të kësaj dispozite gjejmë të përcaktuar pjesët e ndërhyrjes së mbrojtësit në këto procedura dhe mundësisë që ai të angazhohet në hetime, prandaj edhe Kodi i Procedurës Penale i garanton mbrojtësit një kapitull të vecantë “MBROJTËSI I TË PANDEHURIT” nga neni 48 deri tek neni 57 i Kodit të Procedurës Penale. Në këtë kapitull parashtrihen të drejtat dhe detyrimet e mbrojtësit të pandehurit duke i lidhur ngushtësisht ato me të pandehurin. Sipas këtyre neneve kuptojmë se i pandehuri mund të ketë 3 kategori mbrojtësish:

- Mbrojtës të zgjedhur nga i pandehuri neni 48 i Kodit të Procedurës Penale
- Mbrojtës i zgjedhur nga të afërmit neni 48 pika 3 kodi i Procedurës Penale
- Mbrojtës i detyrueshëm për rastet e parashikuara në nenin 49 i Kodit të procedurës Penale
- Mbrojtësi për të pandehurin pa të ardhura financiare neni 49/a Kodi i Procedurës Penale.

Në varësi të llojit të mrbojtësit janë edhe të drejtat që ka ai, duke sqaruar këtu që mbrojtësi i zgjedhur drejtëpërsëdrejti nga i pandehuri, ka më shumë tagra se të tjerët duke qënë se nëpërmjet vullnetit të dejtëpërdrejtë nga i pandehuri, ky i fundit mundet ti kalojë të gjithë tagrat që ligji i garanton vetë të pandehurit.

Në këto kushte cdo kërkesë që ka të drejtë të bëjë i pandehuri e ka të drejtë ta bëjë edhe mbrojtësi, si dhe cdo informacion që ligji ia atribuon të pandehurit ligji ia njeh edhe mbrojtësit. Këtë mënyrë transferimi të të drejtave së pari ligji e garanton nëpërmjet aktit të përfaqësimit të redaktuar sipas nenit 72 Kodi Civil para noterit, po ashtu aktit të përfaqësimit të redaktuar në institucionin e vuajtjes së dënimit si edhe me deklarin në seancën gjyqësore. Në të tre rastet, konsiderohet mbrojtës i zgjedhur nga i pandehuri drejtëpërsëdrejti dhe tagrat që ligji i njeh ngishtësisht të pandehurit ia lejon edhe mbrojtësit.

## **Neni 48**

### **Mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri**

1. I pandehuri ka të drejtë të zgjedhë jo më shumë se dy mbrojtës.
2. Zgjedhja bëhet me deklarin të bërë para organit procedues ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomandë.
3. Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk



e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2.

## **Neni 49**

### **Mbrojtja e detyrueshme**

(Ndryshuar titulli dhe pikat 1, 2, 3, 5, 7 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur:

a) është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç;

b) nuk dëgjon dhe nuk flet;

c) është me aftësi të kufizuara, që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes;

ç) është akuzuar për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënim në maksimum jo më pak se 15 vjet me burgim;

d) akuzohet për një vepër penale, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi;

dh) është deklaruar i ikur ose në mungesë, me vendim gjykate;

e) merret në pyetje personi i arrestuar ose i ndaluar;

ë) në rastet e parashikuara nga paragrafi 5, i nenit 205, ose paragrafi 1, i nenit 296, të këtij Kodi;

f) në çdo rast tjetër të parashikuar nga ligji.

2. Nëse ekzistojnë arsyet për mbrojtje të detyrueshme, sipas këtij neni, organi procedues i cakton menjëherë një mbrojtës të pandehurit. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin

në të gjitha fazat e procedimit, për aq kohë sa ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Mbrojtësi i caktuar, sipas këtij neni, zgjidhet nga organi procedues nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatisë.

4. Gjykata, prokurori dhe policia gjyqësore, kur duhet të kryejnë një veprim për të cilin parashikohet ndihma e mbrojtësit dhe kur i pandehuri është pa mbrojtës, njoftojnë për këtë veprim mbrojtësin e caktuar.

5. Kur kerkohet prania e mbrojtësit dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lene mbrojtjen, gjykata ose prokurori zbaton paragrafin 4, të nenit 350, të këtij Kodi. Nëse mungesa e tij është e përligjur, gjykata ose prokurori mund të caktojë si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.

6. Mbrojtësi i caktuar mund të zëvendësohet vetëm për shkaqe të përligjura. Ai i pushon funksionet kur i pandehuri zgjedh mbrojtësin e tij.

7. Kur mbrojtja nuk mund të sigurohet sipas kësaj dispozite dhe pikës 3, të nenit 49, mbrojtja garantohet nga institucionet që administrojnë ndihmën juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 49/a**

#### **I pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare**

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Kur nuk janë rastet e mbrojtjes së detyrueshme dhe i pandehuri që nuk ka mjete financiare të mjaftueshme kërkon mbrojtës, organi procedues cakton mbrojtësin nga lista e vënë në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas. Shpenzimet e mbrojtjes mbulohen nga shteti.

## **Neni 50**

### **Shtrirja e të drejtave të të pandehurit të mbrojtësi**

1. Mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit.
2. Mbrojtësi ka të drejtë të komunikojë lirisht dhe vetëm për vetëm me të ndaluarin, të arrestuarin apo të dënuarin, të njoftohet paraprakisht për kryerjen e veprimeve hetimore ku është i pranishëm i pandehuri dhe të marrë pjesë në to, t'u drejtojë pyetje të pandehurit, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të njihet me të gjithë materialin e çështjes në përfundim të hetimeve.
3. I pandehuri mund të zhvleftësojë, me deklaram të shprehur, veprimin e kryer nga mbrojtësi para se të jetë marrë një vendim nga gjykata lidhur me këtë veprim.

Gjithashtu edhe viktima ka mbrojtës dhe konkretisht ligji ia garanton këtë me

## **Neni 58**

Të drejtat e viktimës së veprës penale

(Shtuar pika 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:

- a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
- b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
- c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
- ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;**
- d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;
- dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;
- e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
- ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjyqimit;
- f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
- gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife

gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;

h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;

i) të dëgjohej nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;

j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.

3. Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

4. Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1, të këtij neni. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

Të gjitha këto të drejta para ligjit dhe detyra para klientit, avokati i ushtron në bazë të ligjit për avokatinë i cili edhe ky i fundit ka ndryshuar, konkretish Ligj Nr. 55/2018 **“Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”**, gjithmonë në frymën e një aksesimi më të

gjërë të avokatit nëpër institucione dhe në cdo informacion që mund të marrë në kuadër të ushtrimit të detyrës së tij.

Si përfundim, avokati ka të drejtë të marrë informacion për kallëzimin, për procedimin, për aktet në dosje, për fazën e hetimeve, të nënshkruajë akte, të depozitojë prova, të dëgjohet, të bëjë kërkesa e ankesa, etj, për aq kohë sa është mbrojtës sipas mënyrave që shpejtuam më lart. Avokati i personit i cili i fshihet drejtësisë apo është në kërkim, ka të drejtë të paraqitet në cdo fazë të hetimeve të marrë informacione, të pyesë e të angazhohet për mbrojtjen e klientit të tij. Po ashtu avokati është subjekti i cili kërkon njohjen me aktet dhe konsiderohet sikur të kishte marrë dijeni i pandehuri ose viktima, sipas mënyrës së përfaqësimit. Po ashtu, avokati ka të drejtë të takohet drejtëpërsëdrejti me prokurorin e çështjes dhe me oficerin e policisë gjyqësore dhe të marrë informacione në lidhje me çështjen në ngarkim të klientit të tij. Marrëdhënia e avokatit me klientin e tij gëzon mbrojtje të vecantë nga lidhje dhe garanton më së miri edhe cilësinë e procesit për sa i përket faktit se nuk mund të ndërhyhet në këtë raport dhe se është mjaft private si marrëdhënie.

## V. AKTET QË DUHET T'I DREJTOHENI PROKURORISË

Për të realizuar të drejtat e mësipërme, ne propozojmë disa formularë të thejstë për t'iu vënë në shërbim çdo subjekti, të cilit do t'i japë një ndihmesë jo të vogël.

### **KËRKESË**

**KËRKUESI:** Emër MBIEMËR, emri i babait, datëlindja, vendlindja, numri personal dhe numri i dokumentit të identifikimit

**DREJTUAR:** (zgjedh njëren nga subjektet më poshtë)

- Prokurorit;
- Oficerit të Policisë Gjyqësore;
- Drejtuesit të Prokurorisë;
- Sekretarisë;

### **OBJEKTI:**

- Vërtetim për gjëndjen hetimore të një subjekti;
- Vërtetim që ka një proces hetimor për çështje të lidhur civile ose administrative;
- Informacion në lidhje me shortin;
- Informacion në lidhje me fazën hetimore;
- Kopje të akteve;
- Kërkesë për marrjen e provës, etj.

*I, e nderuar*

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

**Ju faleminderit!**



## KËRKESË PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Z./Znj. \_\_\_\_\_

Adresa postare: \_\_\_\_\_

Adresa elektronike: \_\_\_\_\_

Nr. Tel: \_\_\_\_\_

Data: \_\_/\_\_/201\_ Nënshkrimi:

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër,  
mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të  
skanuar)

**Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar**

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

**Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:**

---

---

---

**Vetëm për përdorim zyrtar Data e marrjes:**  
**\_\_/\_\_/2019 Numri rendor i kërkesës: Komente:**

---

---

**Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.**

Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.  Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.  Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

# MEMO

**KËRKUES:** Emër MBIEMËR, lindur me datë, në \_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, I identifikuar me letërnjoftimin me numër \_\_\_\_\_ dhe me numër personal \_\_\_\_\_. Për cdo kontakt shpreh gadishmërinë në numrin e [Tel:+3556](tel:+3556) \_\_\_\_\_ dhe adresë e-mail:emermbiemr@\_\_\_\_\_.com

**DREJTUAR:** z. \_\_\_\_\_

**PROKUROR**

**PËR DIJENI:** z. \_\_\_\_\_, drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor \_\_\_\_\_.

**OBJEKTI:** Informacion në lidhje me fazën e hetimeve

**BAZA LIGJORE:**

- neni 32 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- neni 58, 110 i Kodit të Procedurës Penale

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR** \_\_\_\_\_

**I. Pjesa hyrëse,** që ka të bëjë me fjalët përshëndetëse, statusin tuaj në çështje me të dhënat përkatëse.

**II. Përshkrimi i rrethanave dhe fakteve**

-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----

**III. Ligji I zbatueshëm**

-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----

---

**IV. Arsyetimi I ligjor bazuar mbi faktet bashkëlidhur ligji**

Të nderuar prokurorë,

Në kuadër të të drejtës për një mbrojtje efektive dhe pjesmarrje të barabartë në proces ju bëjmë me dije se pretendimet tona kanë të bëjnë në lidhje me:

Së pari,

---

---

---

---

---

---

Së dyti,

---

---

---

---

---

---

---

Së fundmi

---

---

---

---

---

---

## **V. KONKLuzion**

Në lidhje me sa përshkruam më lart kërkohet nga ana

Juaj

- .....

- .....

**Ju faleminderit**

**Emër MBIEMËR**

**(nënshkrimi)**

# KËRKESË

**KËRKUES:** Emër MBIEMËR, lindur me datë, në \_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, I identifikuar me letërnjoftimin me numër \_\_\_\_\_ dhe me numër personal \_\_\_\_\_. Për cdo kontakt shpreh gadishmërinë në numrin e [Tel:+3556](tel:+3556) dhe adresë e-mail: [emermbiemr@\\_\\_\\_\\_\\_](mailto:emermbiemr@_____).com

**DREJTUAR:** Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

**BAZA LIGJORE:** LIGJ Nr. 119/2014 “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”

## **OBJEKTI:**

- Lëshimin e vërtetimit se ndaj meje kërkuesit nuk ka zhvillohen hetime dhe nuk kam ndonjë proces hetimor në ngarkim timin.

*Të nderuar,*

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, duke qënë se do të marr pjesë në konkurimin \_\_\_\_\_, për të cilin më kërkohen plotësimi i disa dokumentëve, ndër to edhe informacionet në lidhje me faktin se në ngarkim timin

nuk janë zhvilluar hetime për ndonjë çështje penale dhe nuk po zhvillohen të tilla. Në dijeninë time deri më sot nuk kam patur ndonjë problem të kësaj natyre, por provueshmëria për në konkurim kërkon konfirmim zyrtar.

Ky kusht për të marrë vërtetim për gjëndjen time hetimore, bazohet në njoftimin me nr.\_\_\_\_ datë të intitucionit \_\_\_\_\_, si dhe duke qënë se është e dhënë që i takonit personit tim, kam të gjithë tagrat të bëj kërkesën dhe ju keni detyrimin që brënda afatit ligjor, për të drejtën e aksesit mbi të dhënat e mia të më vini në dispozicion dokumentin e kërkuar.

**Ju faleminderit!**  
**Emër MBIEMËR**  
**Nënshkrimi**



## FORMULAR ANKESE

**Drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit  
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

**Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”**

**Emri / Mbiemri :** \_\_\_\_\_

**Adresa:** \_\_\_\_\_

**Qyteti:** \_\_\_\_\_

**Telefon:** \_\_\_\_\_

**E-mail:** \_\_\_\_\_

**Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga  
Autoriteti Publik dhe nëse dispononi dokumente,  
bashkëlidhini** **ato.**

---

---

---

---

---

---

---

---

---

**Përshkruani çfarë kërkonte nga Komisioneri për të  
Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave  
Personale, në përputhje me nenin 24 të ligjit  
nr.119/2014.**

---

---

---

---

---

---

---

**(Data)** \_\_\_\_\_ **(Firma)**

\_\_\_\_\_

**Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për sqarime më të detajuara kontaktoni KDIMDP ose koordinatorin e të drejtës për informim.**

***\*Dërgimi i ankesës elektronikisht ose me postë kërkon bashkëlidhur një kopje të kartës së identitetit .***

## **VI. Aktet që ju garantojnë aksesin në Prokurori**

### **a. Rregullore mbi etikën dhe sjelljen e Prokurorëve**

Urdhër Nr. 141, dt. 19.06.2014 Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljet e Prokurorëve

Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve, (në vijim Rregullat) synojnë të krijojnë, ruajnë dhe forcojnë rregullat e sjelljes, si dhe të rrisin efikasitetin e të gjithë prokurorëve në ushtrimin e funksioneve Kushtetuese dhe ligjore, për llogari të shoqërisë, në interes të publikut dhe në emër të shtetit, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale dhe shtetit të së drejtës. Rregullat përkrahin zbatimin e standardeve të larta të sjelljes profesionale të prokurorëve në të gjithë nivelet, në përshtatje me sjelljen e duhur në zyrë, në gjykatë e jashtë zyrës së tyre, si edhe për forcimin e dinjitetit, pavarësisë dhe integritetit profesional e personal të tyre.

Rregullat shërbejnë si udhëzues për të gjithë prokurorët dhe kandidatët për prokuror në vend, për të rritur ndërgjegjësimin, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Rregullat plotësojnë kuadrin e akteve normative të nxjerra për prokurorët, me synim rritjen e transparencës dhe besimit të publikut ndaj prokurorëve.

Neni 1 Qellimi

Rregullat përcaktojnë parimet, normat dhe udhëzimet e etikës dhe të sjelljes së prokurorëve për të siguruar dhe garantuar profesionalizëm, pavarësi, paanshmëri, ndershmëri, integritet dhe korrektësi në ushtrimin e funksioneve të tyre, për të përmirësuar dhe rritur marrëdhëniet institucionale dhe ndërinstitucionale me subjektet e tjerë të procedimit penal, me institucione dhe organizata kombëtare e ndërkombëtare, duke shmangur konfliktin e interesit dhe ruajtur sekretin profesional, në interes të drejtësisë penale dhe rritjes së besimit të publikut të organi i prokurorisë.

## Neni 2

### Fusha e veprimit

1. Rregullat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga prokurorët e prokurorive të tre niveleve dhe nga magjistratët kandidat për prokuror në periudhën e stazhit profesional në prokurori.

## Neni 3

### Parimet themelore

1. Prokurorët në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat, duhet që:

- a) Të kryejnë detyrat e tyre, në zbatim të Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;
- b) Të ruajnë dinjitetin dhe nderin e profesionit të tyre, duke konsideruar se po veprojnë në emër të shtetit, shoqërisë dhe interesit publik;

- c) Të përmbushin funksionet e tyre, duke ruajtur standardet më të larta profesionale, të integritetit dhe kujdesit, si dhe duke vepruar, me ndershmëri, drejtësi, përkushtim dhe në kohën e duhur;
- c) Të forcojnë shtetin e së drejtës, duke respektuar, mbrojtur dhe garantuar dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut, si dhe duke shmangur çdo formë diskriminimi;
- d) Të respektojnë parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, në mbrojtje të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme, të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, ashtu dhe të dyshuarve, personave nën hetim, të pandehurve dhe të denuarve;
- dh) Të perpiqen të përcaktojnë një ekuilibër midis interesave të përgjithshme të shoqërisë dhe të drejtave të individëve;
- e) Të demonstrojnë cilësi dhe karakter të lartë moral, të jenë të kualifikuar ligjërisht e të trajnuar dhe të ndërgjegjshëm në çdo kohë për detyrat e tyre në ruajtjen e reputacionit të prokurorisë;
- e) Të jenë dhe të tregohen objektivë, të pavarur, të paanshem, të shmangin çdo papajtueshmeri me funksionin e tij, të ndërgjegjshëm për detyrimet etike e profesionale dhe të veprojnë në atë mënyrë që të nxisin besimin e publikut në dinjitetin, integritetin dhe ndershmërinë e tyre;
- f) Të dëshmojnë respekt dhe të tregojnë kujdes për të mos dhënë publikisht mendime personale rreth gjyqtarëve, dëshmitarëve apo të pandehurve, përveç

atyre mendimeve që lidhen me zbatimin e ligjit nga ana e tyre.

#### Neni 4

##### Pavarësia

Prokurorët në ushtrimin me pavarësi të funksioneve apo detyrave të tyre, duhet që:

- a) Të ushtrojnë funksionet e tyre, mbi bazën e vlerësimit të saktë të fakteve, në përputhje me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit dhe të çliruar nga çdo ndikim i panevojshëm ose influencë e jashtme;
- b) Të shmangin çdo përpjekje të parregullt apo të paligjshme, që mund të ndikojë ose manipulojë vlerësimet dhe vendimmarrjen e tyre;
- c) Të mos kërkojnë apo pranojnë përfitime ose avantazhe materiale apo jomateriale, për vete, familjarët e tyre, persona të tretë apo institucione, interesa të lidhura drejtpërdrejt ose të tërthortë me rezultatin e procedimit apo çeshtjes që ata kanë në ndjekje;
- 9) Të mos zhvillojnë veprimtari ekonomike, përfshirë çdo lloj pune apo biznesi për të përfituar interesa materiale ose jomateriale, që mund të ndikojnë në pavarësinë e tyre, ose që mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tyre ose personave të tjerë, si dhe nuk duhet të anëtarësohen në organizata shoqërore, të cilat krijojnë dyshimin se kompromentojnë figurën e prokurorit apo janë të papajtueshme me funksionin e tij;

- d) Të mos ndikohen nga interesat e grupeve të caktuara dhe nga presionet e mediave dhe të publikut;
- dh) Të respektojnë të drejtat e të gjithë personave për të qenë të barabartë përpara ligjit dhe të shmangin diskriminimin e çdo personi për arsye të tilla si: seksi, race, ngjyre, gjuhe, feje, bindjeje politike apo bindjesh të tjera, orientimi seksual, origjine shoqërore apo kombëtare, lidhjeje me një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, shëndetësore apo ndonjë statusi tjetër;
- e) Të mos lejojnë që emri dhe reputacioni i tyre të përdoret nga persona të tjerë për qëllime përfitimesh të padrejta.

## Neni 5

### Paanësia

1. Prokurorët në ushtrimin me paanshmëri të funksioneve apo detyrave të tyre, duhet që:

- a) Të mos lejojnë që i dyshuari, personi nën hetim apo i pandehuri të bëhet objekt dhune, presioni apo torture, sidomos për t'i detyruar të fajësojnë veten apo të shpallen fajtor mbi shpjegime të marra në kundërshtim me ligjin;
- b) Të respektojnë të drejtat e të gjithë personave për të qenë të barabartë përpara ligjit dhe të veprojnë me objektivitet e paanshmëri, duke shmangur çdo diskriminim dhe paragjykim në lidhje me përkatësinë politike, etnike, sociale, kulturore, fetare ose gjinore, orientimi seksual, moshën, statusin, paaftësinë fizike apo mendore;

- c) Të jenë të paanshëm – të duken që janë - dhe të perceptohen të tillë nga opinioni publik;
- c) Të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të drejtat e personit nën hetim dhe të pandehurit në procedim penal;
- d) Të tejkalojnë paragjykimet kulturore që mund të ndikojnë në kuptimin dhe vlerësimin e fakteve, si dhe interpretimin apo zbatimin e ligjeve;
- dh) Të jenë tolerantë dhe të hapur edhe për diskutime dhe zgjidhje të ofruara në mënyrë të ligjshme dhe të marrin parasysh pikëpamjet, interesat ligjore, jetën private dhe shqetësime të tjera të personave që i kanë kontaktuar;
- e) Të mos japin shërbim ligjor, përveç rasteve të mbrojtjes së të drejtave vetjake/personale, familjarve apo të afërmve të tyre.

## Neni 6

### Profesionalizmi

1. Prokurorët në mënyrë që të ruajnë një nivel të lartë profesional në ushtrimin e kompetencave të tyre, duhet të jenë të mirinformuar, të trajnuar dhe në të njëjtin hap me zhvillimet ligjore dhe shoqërore përkatëse.
2. Ata duhet të zhvillojnë aftësitë profesionale, duke u azhurnuar me ndryshimet ligjore në fushën penale, duke ndjekur jurispondencën gjyqësore shqiptare dhe ndërkombëtare, duke thelluar njohuritë në strukturat ku ushtrojnë funksionet dhe duke marrë pjesë në kurse/trajnime profesionale.



## Neni 7

### Kompetencat

1. Prokurorët në ushtrimin e kompetencave të tyre me standardet profesionale më të larta, në të gjithë kohën, duhet që:

a) Të veprojnë me kompetencë dhe përkushtim në ushtrimin e funksioneve të tyre me drejtesi, paanësi dhe objektivitet, duke respektuar dispozitat ligjore, në mënyrë të pavarur dhe duke marrë parasysh në radhe të parë interesin publik;

b) Të tregojnë durim, mirësjellje dhe korrektësi në kryerjen e detyrës pa vonesa, duke ruajtur gjithmonë sjelljen e duhur, dhe duke shmangur konflikte që mund të shkaktojnë dyshime për paragjykim, mungese aftësie apo përgatitjeje;

c) Të procedojnë me vendosmëri dhe të vendosin mbi bazën e provave përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe në bazë të ligjit;

ç) Të shqyrtojnë provat e propozuara për të parë nëse janë marrë në mënyrë të ligjshme;

d) Të kundërshtojnë, ndaj cilitdo, përdorimin e provave, të cilat besohet të jenë marrë me anë të metodave të paligjshme, të cilat përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të dyshuarve, personave nën hetim apo të pandehurve;

dh) Të sigurojnë që janë kryer veprimet dhe janë marrë masat e duhura ndaj personave përgjegjës në marrjen e provave me përdorim të metodave të paligjshme;

- e) Të respektojnë parimin e barazisë së palëve, në mënyrë të veçante, duke njohur të akuzuarin apo mbrojtjen e tij me provat në përputhje me ligjin dhe parimin e procedimit të drejte dhe të rregullt ligjor;
- ë) Të garantojnë që janë kryer ose janë duke u kryer të gjitha hetimet e mundshme apo të domosdoshme, para marrjes së vendimit përfundimtar lidhur me procedimin, ose para se të merren vendime të tjera që mund të ndikojnë rrjedhën e zgjidhjes ligjore të procedimit/çështjes;
- f) Të shikojnë të gjitha rrethanat përkatëse të një çështjeje, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me të dyshuarin, pavarësisht se ato më vonë mund të jenë në avantazh apo disavantazh të tij;
- g) Të mos fillojnë procedimet, ose edhe nëse kanë filluar, të pushojnë akuzën ose çështjen kur një hetim i paanshëm tregon që akuza është e pabazuar, sipas rasteve të parashikuar në ligj, duke siguruar transparencë në ushtrimin e vendimmarrjes, si dhe duke arsyetuar shkaqet në rastet kur është vendosur mosfillimi i procedimit, pezullimi i hetimit apo pushimi i akuzës dhe/ose çështjes;
- gj) Të mbështesin parimin e një procedimi dhe gjykimi të drejtë, siç është përcaktuar në Kushtetutë<sup>1</sup>, në KEDNJ<sup>2</sup>, dhe në ligj;
- h) Të kërkojnë që të garantohet se, sistemi i drejtësisë penale vepron në mënyrën më të shpejtë të mundshme, në përputhje me interesat e drejtësisë;

## Neni 8

### Ndershmëria dhe drejtësia

Prokurorët në garantimin e një procedimi të ndershëm dhe të drejtë, duhet që:

- a) T'i sigurojnë gjykatës të gjitha të dhënat dhe provat e mbledhura, edhe kur ato janë në favor apo disfavor të akuzës ose të akuzuarit;
- b) Të trajtojnë në mënyrën e duhur të gjitha çështjet, por me prioritet çështjet me të paraburgosur, ndaj të miturve dhe grave;
- c) Të kujdesen - brenda kompetencës së tyre - që subjektet e procedimeve penale të informohen saktësisht për rolin e tyre në proces dhe të drejtat e tyre;
- ç) Të ruajnë sekretin e hetimeve dhe të administrojnë informacionin konfidencial ose të marrë me mirëbesim;
- d) Të tregojnë sjellje dhe qëndrim korrekt, edhe jashtë sferës së tyre profesionale, për të mos shkaktuar dyshim për ndershmërinë e tyre profesionale.

## Neni 9

### Ruajtja e sekretit profesional

Prokurorët për ruajtjen e sekretit hetimore duhet që:

- a) Të mos përdorin informacionet sekrete apo konfidenciale që disponojnë për shkak të detyrës, për interesin e tyre personal apo të personave të tjerë, përveçse kur ligji e parashikon ndryshe;
- b) Të mos u japin të tjerëve dhe/ose të mos marrin prej kolegëve informacione në lidhje me një hetim, përveçse kur kjo është pjesë e punës së tyre, për të ndihmuar

hetimin ose kur zbulimi i informacionit është i autorizuar me ligj;

c) Të tregojnë diskrecion maksimal në administrimin e informacionit që lidhet me të dëmtuarit, dëshmitaret apo të akuzuarit, duke mos i dhënë akses askujt në këtë informacion, përveçse kur është parashikuar ndryshe në ligj.

## Neni 10

### Integriteti dhe korrektësia

Prokurorët për ushtrimin e funksioneve me integritet dhe korrektësi, në çdo kohë, duhet që:

a) Të përdorin mjetet ligjore që u ofron pozicioni i punës në përputhje me destinacionin e tyre institucional dhe të tregojnë kujdes në përdorimin tyre;

b) Të mos përdorin për qëllime personale prova, sende të sekuestruara ose të konfiskuara pa kaluar në pronësi të organit të prokurorisë sipas ligjit. Ata nuk mund të blejnë nga organe shtetërore apo në ankand këto sende dhe/ose të tjera objekt sekuestrimi ose konfiskimi në procedimin penal apo në procedimin civil që lidhet me procedimin penal të ndjekur prej tyre ose çdo procedim tjetër në të cilin prokurori është palë, përveçse kur është bashkepronar;

c) Të bëjnë kujdes në administrimin e dosjeve zyrtare në vende jashtë ambienteve zyrtare;

ç) Të përdorin kohën e punës në mënyrë efektive për realizimin e detyrave zyrtare. Kjo kohë nuk përdoret për

asnjë qëllim tjetër, përveçse kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar zyrtarisht.

d) Veshja dhe paraqitja e prokurorëve duhet të jenë formale dhe serioze, për t'u përfaqësuar sa më denjësisht, si gjatë kryerjes së detyrës dhe në jetën e përditshme. Në mënyrë të veçantë, gjatë orarit zyrtar, janë të papranueshme mbajtja e vjeshjeve të papërshtatshme;

dh) Prokurorët nuk duhet të përdorin substanca që ndikojnë në gjendjen e tyre, të cilat nuk janë rekomanduar nga mjeku. Ata gjatë orarit zyrtar dhe ushtrimit të detyrës nuk duhet të konsumojnë dhe nuk duhet të jenë nën efektin e alkoolit apo substancave që ndikojnë gjendjen e tyre mendore dhe emocionale.

e) Prokurorët nuk duhet të frekuentojnë ambiente apo lokale, të cilat dëmtojnë imazhin e tyre si prokuror.

ë) Prokurorët duhet të respektojnë ligjet dhe t'u binden në çdo kohë akteve të organeve ligjzbatuese.

## Neni 11

Ndalime të përfitimeve dhe konflikti i interesave

Prokurorët nuk duhet që:

a) Të përdorin detyrën e tyre për të përfituar privilegje për vete ose për persona të tjerë;

b) Të marrin vendime procedurale/profesionale të ndikuar nga preferenca politike ose interesa financiare të tyre, të familjes, të miqve apo personave të tretë, apo bazuar në ndikimin që mund të ketë ndonjë organizatë apo grup të cilit prokurori i përket;

c) Të kërkojnë ose të marrin, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat u jepen për shkak të pozicionit të tyre, nga një individ, person fizik ose juridik privat. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare;

ç) Të lejojnë që emri dhe reputacioni i tyre të përdoren nga të tjerët me qëllim përfitimesh të padrejta.

d) Prokurori më i lartë nuk duhet të pranojë shërbime apo dhurata nga prokurorë apo punonjës në vartësi të tij.

dh) Prokurori që ka bërë kërkesë për ngritje në detyrë, transferim apo një pozicion tjetër, nuk duhet të ushtrojë asnje lloj ndikimi tek persona që janë të përfshirë në vlerësimin, shqyrtimin apo vendimmarrjen lidhur me këtë kërkesë.

e) Prokurori duhet të zbatojë detyrimet e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar).

## Neni 12

### Veprimtaritë e jashtme

1. Kryerja e veprimtarive të jashtme në perputhje me nenin 39, pika 2 të ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), është e lejueshme kur ato veprimtari nuk pengojnë kryerjen e

detyrës dhe nuk cenojnë pavarësinë ose paanësinë e prokurorëve.

2. Prokurori duhet në çdo rast të njoftojë drejtuesin e prokurorisë dhe Prokurorin e Pergjithshëm për angazhimin e tij në këto veprimtari dhe të marrë paraprakisht miratimin e tyre.

### Neni 13

Marrëdhëniet epror-vartës, marrëdhëniet me kolegët dhe administratën

1. Në përputhje me organizimin dhe funksionimin e prokurorisë si organ i centralizuar dhe në respektim të shkallës së hierarkisë në prokurori, marrëdhëniet epror-vartës ndërmjet prokurorëve do të sigurojnë bashkëpunim maksimal për të arritur rezultatin më të mirë në miradministrimin e drejtësisë. Në këto marrëdhënie duhet që:

a) Prokurorët të udhëhiqen nga respekti, përkushtimi, transparenca, serioziteti, mirësjellja e ndershmëria për zbatimin me përpikmëri të urdhrave e udhëzimeve të ligjshme të prokurorit më të lartë;

b) Prokurorët më të lartë të respektojnë të drejtat dhe dinjitetin e prokurorëve më të ulët, t'i vlerësojnë në kryerjen e detyrave, t'i ndihmojnë në vështirësitë që ata kanë në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të ngarkuara dhe të bashkëpunojnë me ta në interes të rritjes së efektivitetit dhe ligjshmërisë në veprimtarinë institucionale të prokurorisë.

2. Në marrëdhënie me kolegët prokurorët duhet që:

- a) Të dëshmojnë respekt dhe nuk duhet të flasin apo të veprojnë në mënyra të tilla që prekin dinjitetin dhe personalitetin e të tjereve;
- b) Të bashkëpunojnë dhe ndajnë eksperiencat e tyre, por pa ndikuar në vendimmarrjen e kolegut në raste konkrete;
- c) Të mos ndërmarrin veprime për të ndikuar tek ndonjë prej kolegëve për të shkelur rregullat e përcaktuara në këtë Kod.

3. Në marrëdhënie me vartësit dhe administratën prokurorët duhet që:

- a) Të sillen me respekt, konsideratë dhe drejtësi;
- b) Të bashkëpunojnë me ta dhe t'u japin informacion apo akses në të dhëna në mënyrë që të realizojnë detyrat e caktuara;
- c) Të bashkëpunojnë dhe ndihmojnë në rritjen e tyre profesionale;
- ç) Të mos ndikojnë apo ushtrojnë presion mbi ta për t'i detyruar të kryejnë veprime që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës.

#### Neni 14

Marrëdhëniet me subjektet e procedimit penal

1. Në marrëdhënie me gjyqtarët, prokurorët duhet që:

- a) Në përfaqësimin e çështjeve apo akuzës në gjykatë, të zbatojnë me korrektësi dhe përpikmëri të gjitha detyrat dhe të drejtat që parashikon legjislacioni në fushën penale, duke mos kryer veprime e sjellje te



papërshtatshme, që ulin dinjitetin e figurës së tyre para publikut;

b) Të respektojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, pavarësisht bindjes së tyre, duke mos vënë në dyshim vendimet e tyre dhe duke urdhëruar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me përjashtim të rasteve kur ushtrojnë të drejtën e ankimit në përputhje me ligjin;

c) Të jenë objektivë dhe korrektë gjatë procedurës gjyqësore dhe të ndihmojnë në miradministrimin e drejtësisë nga gjykata;

ç) Të respektojnë oraret e seancave dhe të bëjnë kërkesa ligjore për të mundësuar që të sigurohet e drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm;

2. Në marrëdhënie me policinë gjyqësore, prokurorët duhet që:

a) Të nxisin bashkëpunimin e duhur dhe funksional;

b) Të krijojnë marrëdhënie korrekte të bazuar në besim dhe reciprocitet;

c) Të shkëmbejnë reciprokisht përvojën dhe njohuritë e tyre ligjore me oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore;

ç) Të japin urdhra dhe udhëzime të qarta, si dhe të drejtojnë, ndihmojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë e tyre që të arrihet ndjekje penale efikase;

d) Të sigurojnë transparencë, por pa dëmtuar hetimin;

3. Në marrëdhënie me të akuzuarit, të dëmtuarit dhe dëshmitarët, prokurorët duhet që:

a) Të zbatojnë detyrat e tyre me drejtësi, paanshmëri, objektivitet dhe efikasitet;

- b) Të respektojnë dinjitetin dhe personalitetin e njeriut;
- c) Të drejtojnë hetimet në kërkim të së vërtetës, duke administruar edhe provat në favor të të pandehurit dhe duke mos lejuar, me dijeninë e tij, përdorimin e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme;
- ç) Të sigurojnë asistencë ligjore dhe/ose sociale, në përputhje me kërkesat ligjore në çështje konkrete;
- d) T'u sigurojnë këtyre subjekteve informacionin e duhur lidhur me statusin e tyre, duke shmangur dhënien e mendimeve personale ose deklarata lidhur me mënyrën e përfundimit të çështjes.

## Neni 15

Marrëdhëniet me institucionet dhe organizatat

1. Në marrëdhënie me institucionet dhe organizatat kombëtare e ndërkombetare, prokurorët duhet që:

- a) Të bashkëpunojnë me profesionalizëm, duke respektuar kompetencat dhe pavarësinë e çdo institucioni. Marrëdhëniet të bazohen në principet e bashkëpunimit, mosdiskriminimit, respektit dhe besimit reciprok, si dhe të zbatimit të kërkesave ligjore;
- b) Të bashkëpunojnë me autoritetet gjyqësore ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat e njeriut, dokumentat ndërkombëtarë të miratuara dhe legjislacionin vendas e të huaj, si dhe duke shmangur vonesat e panevojshme.

## Neni 16

Liria e të shprehurit dhe marrëdhëniet me median

1. Prokurorët duhet që:

a) Të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u shprehur vetëm në përputhje me dinjitetin e detyrës së tyre;

b) Të mos bëjnë deklarata publike ose vërejtje që dëmtojnë autoritetin e prokurorisë ose krijojnë dyshime mbi paanësinë e saj;

c) Të mos bëjnë publike ose t'u japin personave të tretë të dhëna që mund të dëmtojnë çështjen në hetim apo në gjykim, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar;

ç) Të mos bëjnë deklarata ose të japin mendime për veprimtarinë e organeve të tjera.

2. Prokurori jep njoftime lidhur me aktivitetin e tij brenda kufijve të lejuar nga ligji procedural penal dhe aktet nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm, që rregullojnë marrëdhëniet me median.

Neni 17

Shkelja e Rregullave

1. Shkelja e Rregullave, kur nuk përbën vepër penale, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor.

2. Veprime që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit përbëjnë shkeljet e Rregullave, të parashikuara ne: nenin 4, pika 1, germat "b", "c", "d", "e"; nenin 5, pika 1, germat "a"ç "e"; nenin 7, pika 1, germat "d", "dh", "g"; nenin 8, pika 1, germa "d"; nenin 10, pika 1, germat "a", "b" dhe pikat 2, 3 e 4; nenin 11, pika 1, germat "a", "b", "c", "ç" dhe pika 2; nenin 13, pika 3 germa "ç"; nenin 14, pika 1, germa "a"; nenin 16, pika 1, germat "b", "c"; si

dhe akte e sjellje të tjera në shkelje të Rregullave, që rast pas rastit vlerësohen se kanë diskredituar rëndë pozitën dhe figurën e prokurorit.

3. Në rastet kur veprimet dhe sjelljet e prokurorit vlerësohen se kanë efekte të ngjashëm me Rregullat, edhe nëse ato nuk janë parashikuar shprehimisht, konsiderohen shkelje të Rregullave.

#### Neni 18

##### Kontrolli i zbatimit të Rregullave

1. Për zbatimin e Rregullave ngarkohen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjithë niveleve.

2. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e Rregullave ngarkohet prokurori-Inspektor i Etikës, në përbërje të Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme. Ai mund të kryejë dhe detyra të tjera në përbërje të kësaj drejtorie.

#### Neni 19

##### Inspektori i Etikës dhe procedura e ndjekur prej tij

1. Inspektor i Etikës caktohet me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm një nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.

2. Inspektori i Etikës, kryesisht ose brenda 10 ditësh nga marrja dajeni për shkelje të Rregullave nga prokurori, fillon procedurën e verifikimeve për të vërtetuar nëse ka patur ose jo shkelje të tilla.

3. Çdo punonjës i prokurorisë që ka dajeni mbi shkelje të Rregullave, duhet të bashkëpunojë me Inspektorin e

Etikës, duke dhënë deklarata të verteta dhe të plota dhe duke treguar ekzistencën e rrethanave dhe vendndodhjen e provave.

4. Inspektori i Etikës informon Prokurorin e Përgjithshëm për rezultatet e verifikimeve dhe i rekomandon sipas rastit, regjistrimin e procedimit penal, fillimin e procedimit disiplinor apo organizimin e trajnimeve të posaçme. Një kopje e këtij informacioni i njoftohet prokurorit të interesuar.

5. Inspektori i Etikës njihet me aktin e vlerësimit të prokurorit dhe bashkërendon me drejtuesit e Prokurorive, drejtuesin e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore dhe Këshillin e Prokurorisë për çështje të vlerësimit të disiplinës në punë të prokurorëve.

## Neni 20

### Bashkepunimi me Inspektorin e Etikës

1. Prokurori raporton me shkrim tek Inspektori i Etikës, për shkelje të Rregullave nga eprorët, kolegët apo vartësit, pasi t'i kete sugjeruar dhe lënë kohë të arsyeshme, por jo më shumë se dhjetë ditë, për raportimin nga ai vetë të shkeljes.

2. Prokurori, i cili është i pasigurt, nëse një sjellje e caktuar përbën shkelje të Rregullave, mund të njoftojë Inspektorin e Etikës rreth të gjitha fakteve dhe rrethanave në lidhje me situatën dhe të kërkojë mendim prej tij. Inspektori i Etikës i përgjigjet menjëherë me shkrim.

3. Prokurori që ka marrë përgjigje me shkrim nga Inspektori i Etikës, pasi i ka dhënë atij të gjitha faktet që lidhen me shkeljen e Rregullave dhe ka ndjekur këshillat e tij, është subjekt i procedimit disiplinor, përveçse kur shkelja përbën vepër penale.

#### Neni 21

##### Azhornimi i Rregullave

1. Rregullat i nënshtrohen rishikimit të vazhdueshëm dhe mund të ndryshohen në çdo kohë sipas dispozitave përkatëse të ndryshuara të Kodit të Procedurës Penale dhe akteve normative të mbështetur në të.

2. Ndryshimet dhe/ose shtesat bëhen pasi jepet mendim për miratim nga Këshilli i Prokurorisë. Çdo ndryshim i bërë nuk ka fuqi prapavepruese.

#### Neni 22

##### Njoftimi

1. Rregullat, kundrejt nënshkrimit për marrjen dijeni, duhet t'u njoftohen:

a) Magistratëve, kandidat për prokuror gjatë kryerjes së stazhit profesional në prokurori;

b) Prokurorit, në momentin e emërimit me Dekret të Presidentit;

c) Të gjithë prokurorëve dhe oficerëve apo agjentëve të Policisë Gjyqësore të përfshirë në prokurori;

ç) Prokurorët duhet të njoftohen edhe për çdo ndryshim ose shtesë të këtyre Rregullave.

Neni 23

Miratimi dhe hyrja në fuqi

1. Rregullat u miraruan, pas diskutimit të gjerë me prokurorët e të gjithë niveleve dhe pasi u dha pëlqimi/mendimi për miratim nga Këshilli i Prokurorisë.

2. Rregullat hyjnë në fuqi menjëherë.

## **b. RREGULLORE E BRENDSHME E PROKURORISE**

Në faqet elektronike gjendet publikimi i Rregullores së Brendshme të Prokurorisë së Përgjithshme, i cili pasi rregullon strukturën dhe funksionimin e organeve të Prokurorisë së Përgjithshme, ndër të tjera ka të mirërregulluar edhe Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit. Kjo drejtori e përbërë nga: a) Drejtori; b) Specialist, administrator rrjeti; c) Specialist, Programator (software); ç) Specialist për rrjetin fizik, kompjuterik dhe telefonik; d) specialist; dh) sekretar, ka për objekt koordinimin e projekteve të reja dhe ato ekzistuese në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Implementimin e sistemeve kompjuterike të azhurnuara me progreset më të fundit teknologjike, dhënien e kontributit në përgatitjen e politikave të zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe kujdesin për realizimin e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

Detyrat dhe te drejtat kryesore të Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit janë edhe:

a) menaxhimi dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve informatike dhe infrastrukturës së saj, duke përfshirë sistemet e shkëmbimit të informacionit, rrjetin kompjuterik, hardware-t (pajisjet kompjuterike), software-t (programet) dhe mjetet e tjera të komunikimit në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) drejtimi dhe monitorimi i sistemeve të teknologjise dhe informacionit në Prokurorinë Shqiptare;

c) njohja me ndryshimet dhe avancimet e teknologjisë dhe adaptimi me progreset më të fundit të saj për të mirën e punës së përditshme dhe projektet në vazhdimësi për Prokurorinë Shqiptare;

ç) drejtimi i punës për kryerjen e studimeve të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit dhe përmirësimin e komunikimit elektronik në Prokurori;

d) drejtimi i punës për mirëmbajtjen e paisjeve kompjuterike dhe sistemeve të komunikimit në Prokurori;

dh) marrja pjesë në konferenca, grupe pune të ndryshme, seminare lidhur me çështjet e Teknologjise së Informacionit;

e) rritja e përdorimit të teknologjisë nëpërmjet ofrimit të teknologjive të reja për përmirësimin e komunikimit efektiv;

ë) publikimi në faqen zyrtare të internetit, të lajmeve dhe informacioneve të nevojshme të paraqitura nga strukturat e ndryshme të Prokurorisë;



f) ofrimi i asistencës në përzgjedhjen e pajisjeve kompjuterike dhe programeve të ndryshme, instalimi i tyre dhe asistenca teknike në përdorimin e këtyre pajisjeve dhe programeve të tyre, duke ofruar kështu trajnim dhe duke përgatitur manuale mbi përdorimin e pajisjeve kompjuterike;

g) mirëmbajtja e postës elektronike, serverave, antivirus, backup etj.

gj) përgjegjësia për organizimin e punës në funksion të kryerjes së detyrave të ngarkuara, për realizimin e misionit të drejtorisë.

Edhe pse jetojmë në epokën e teknologjisë së Informacionit, faktikisht ky shërbim nuk ofrohet nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rregullorja e mësipërme deri sot nuk është zbatuar për këtë organ.

### **c. LIGJI PER FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E ORGANIT TE PROKURORISE**

Për arsye volumi nuk do të citohet i gjithë ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSh”, por vetëm dispozitat më të rëndësishme që lidhen me të drejtën e informimit, aksesit dhe cilësisë së shërbimeve administrative në organin e Prokurorisë.

Dispozitat e mëposhtme shërbejnë si burime të rëndësishme të së drejtës, ku mund të mbështetet qytetari në kërkesat e tij drejtuar organit të Prokurorisë.

#### Neni 4

##### Ligjshmëria e veprimtarisë

1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi.
2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik.

#### Neni 5

##### Detyrueshmëria e ndjekjes penale

Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

#### Neni 6

##### Pavaresia e prokurorëve

1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashirojnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.
2. Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat.

#### Neni 8

##### Objektiviteti dhe barazia

Prokurorët sigurojnë trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, pronës, arsimimit, lindjes, aftësisë së kufizuar, origjinës shoqërore, përkatësisë prindërore ose për arsye të tjera.

#### Neni 9

##### Konfidencialiteti i të dhënave

1. Prokurorët dhe gjithë personeli i prokurorisë, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si edhe pas përfundimit të saj, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin shtetëror për fakte për të cilat vihen në dijeni, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

2. Prokurorisë nuk i lejohet të bëjë publike ose t'u japë personave të tretë të dhëna që dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi, që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, të drejtat e të miturve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

3. Prokurorëve u ndalohet të bëjnë deklarata ose të japin mendime për veprimtarinë e organeve të tjera.

#### Neni 10

Respektimi i rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale  
Prokurorët duhet të ruajnë në çdo kohë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre dhe të sillen në mënyrë profesionale, në përputhje me ligjin dhe rregullat e etikës.

#### Neni 52

Drejtimi administrativ i prokurorisë

1. Drejtuesi i prokurorisë është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton.
2. Prokurorët kanë detyrimin të informojnë drejtuesin e prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me punën mbi çështje të caktuara dhe vendimmarrjen, si dhe, në raste të veçanta, për problematika që shfaqen në ecurinë e procedimit.
3. Drejtuesi i prokurorisë merr masa për të garantuar përmbushjen e funksioneve administrative të prokurorisë, përfshirë mbajtjen e regjistrave dhe raporteve, mbajtjen e protokollit dhe arkivit, administrimin financiar dhe material, menaxhimin informatik, ndarjen e brendshme e detyrave, shqyrtimin e ankesave dhe detyra të tjera që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë.

## ADMINISTRATA E PROKURORISË

### Neni 57

Organizimi i administratës së prokurorisë

1. Administrata e prokurorisë realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve të mëposhtme:

a) shërbimet e prokurorisë, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë e prokurorisë, duke përfshirë dokumentimin dhe aktivitete që kryhen nga kancelari dhe sekretaria;

b) shërbimet administrative, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin e prokurorisë, sigurinë, si dhe burimet njerëzore;

c) shërbimet mbështetëse, që sigurojnë në mënyrë të veçantë kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen sanitare të prokurorisë, mirëmbajtjen e mjediseve të prokurorisë.

2. Veprimtaritë që duhet të kryhen për secilin nga këto shërbime përcaktohen në rregulloren standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm ose Prokurori i Posaçëm, respektivisht, sipas fushës së përgjegjësisë përkatëse.

### Neni 58

Kancelari

1. Kancelari i prokurorisë ndihmon drejtuesin e prokurorisë në përmbushjen e detyrimeve për administrimin e prokurorisë.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij, kancelari kryen këto detyra:

a) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e personelit administrativ, administron mjediset e punës, mjetet financiare dhe burimet materiale të prokurorisë, nën autoritetin e Drejtuesit të Prokurorisë;

b) kryen funksionin e nëpunësit autorizues të nivelit të dytë për prokurorinë dhe është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të prokurorisë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe legjislacionit për menaxhimin buxhetor e financiar;

c) drejton dhe organizon veprimtarinë e zyrës së sekretarisë;

ç) ndjek zbatimin e rregullave të etikës dhe të rregullores së brendshme nga punonjësit e prokurorisë, njofton drejtuesin e prokurorisë për rastet e shkeljeve, si dhe rekomandon masat e nevojshme;

d) ndjek veprimtarinë për sigurinë dhe mirëmbajtjen e godinës;

dh) merr masa dhe kujdeset për pajisjen e prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore me mjete kancelarike, literaturë nga fushat e drejtësisë, si dhe artikuj të tjerë të domosdoshëm për funksionimin normal të prokurorisë;

e) së bashku me sekretarinë, përgatit informacionet statistikore që i dërgohen drejtuesit të prokurorisë;

- ë) i propozon drejtuesit të prokurorisë nevojat për përmirësimin e strukturës dhe organizimit të administratës, sipas limitit organik të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm;
- f) merr masa dhe kujdeset për mirëmbajtjen e regjistrave dhe librave të tjerë të prokurorisë;
- g) mbikëqyr veprimtarinë e përditshme të administratës, me qëllim evidentimin dhe informimin e drejtuesit të prokurorisë për çështjet dhe problematikat e konstatuara;
- gj) informon drejtuesin e prokurorisë në lidhje me çdo problem të lindur në prokurori, si dhe jep mendim për zgjidhjen e tyre;
- h) zbaton urdhrat dhe udhëzimet e drejtuesit të prokurorisë në lidhje me mbarëvajtjen e veprimtarisë në institucion;
- i) mban regjistrin e personelit dhe dokumentacionin për personelin e administratës, në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
- j) kryen detyra të tjera që i ngarkohen nga drejtuesi i prokurorisë.

## Neni 59

### Sekretaria e prokurorisë

1. Sekretaria e prokurorisë kryen funksione administrative dhe procedurale në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Sekretaria e prokurorisë ushtron në veçanti funksionet e mëposhtme:

- a) vërteton aktet e prokurorisë dhe lëshon vërtetime ose kopje të njësuara me origjinalin. Kur përdoren pajisje regjistrimi ose pajisje që kryejnë funksione të ngjashme, sekretaria garanton që regjistrimi ose riprodhimi është origjinal dhe i paprekur;
- b) ndihmon në mbajtjen dhe administrimin e dosjeve;
- c) ndihmon në mbajtjen e regjistrave, si dhe për regjistrimet në regjistra dhe ndihmon në mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike atje ku këto janë të disponueshme;
- ç) bashkëpunon me autoritetet kompetente për çështje të taksave dhe tarifave;
- d) ndihmon në krijimin e statistikave të prokurorisë, sipas kriterëve të përcaktuara për këtë qëllim dhe për saktësinë e të dhënave; dhe
- dh) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

2. Veprimtari të tjera, të cilat kryhen rregullisht nga sekretaria e prokurorisë, renditen në rregulloren standarde të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

## Neni 61

### Marrëdhëniet me publikun

1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit.



2. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen nën drejtimin e prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe mbikëqyren prej tij.
3. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.
4. Drejtuesi i prokurorisë cakton nëpunësin civil për marrëdhëniet me publikun si koordinator në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit".

#### Neni 62

Shërbimi i teknologjisë së informacionit

Shërbimet e teknologjisë së informacionit sigurojnë:

- a) mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në prokurori, të mbajtura në formë elektronike, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale; si dhe
- b) ruajtjen e rregullt të statistikave të prokurorisë.

#### Neni 63

Shërbimi i arkivit të prokurorisë

1. Shërbimi i arkivit të prokurorisë mban dhe administron dokumentacionin e prokurorisë, i cili përfshin dosje, regjistra dhe akte të tjera të prokurorisë, si dhe akte që lidhen me veprimtarinë administrative të

saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërorë.

2. Shërbimi i arkivit të prokurorisë bashkëpunon me Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit të prokurorisë, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit.

#### Neni 64

Rregulli dhe siguria në prokurori

1. Rregulli dhe siguria në prokurori rregullohen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Këshilli i Ministrave, pasi merr mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përcakton kriteret dhe procedurat për garantimin e rregullit dhe sigurisë në prokurori.

3. Siguria në Prokurorinë e Posaçme rregullohet sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm.